



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.16/2018

Prishtinë, më 21.02.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha – Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Dardan Molliqaj, Hykmete Bajrami, Mimoza Kusari - Lila, Memli Krasniqi, Bilall Sherifi dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Gani Dreshaj dhe Qëndron Kastrati, anëtarë.

I ftuar: Faton Thaqi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Nazim Zenelaj, Agim Kukaj dhe Marcelë Restelica - MZHE; Remzije Hajdari, Nystret Vojvoda, Isa Elshani, Meruan Rexhepi dhe Gurakuq Kastrati – MTI; Dren Ajeti – KPK; Qendresa Kastrati- KDI; Adelina Hasani – KDI dhe Detjan Hulaj – ICHAT.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha -Shala, kryetare e komisionit, e ndihmuar nga Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 7.2.2018 dhe 14.2.2018;
- 3.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-038 për Shërbimet Postare;
- 4.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-037 për Metrologji;
- 5.Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;
- 6.Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve;
- 7.Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratuan pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 7.2.2018 dhe 14.2.2018

Procesverbalet, nga mbledhjet e mbajtura më 7.2.2018 dhe 14.2.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-038 për Shërbimet Postare

Kryetarja tha se është përfaqësuesi i ministrisë këtu për të prezantuar projektligjin dhe ia dha fjalën, që të bëjë prezantimin e projektligjit për Shërbimet Postare.

Nazmi Zenelaj, sekretar i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, para se të paraqiste ekspozenë e projektligjit, kërkoi ndjesë në emër të ministrit Lluka, që s'ka mundur të jetë sot në komision dhe asnjë nga zëvendësministrat. Si ministri përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit në fushën e shërbimeve postare, ka paraparë në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë për vitin 2017 edhe hartimin e Projektligjit për Shërbimet Postare. Kjo objektive është reflektuar edhe në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-s. Gjatë hartimit të këtij Projektligji është shfrytëzuar asistenca teknike e TAIEX-it (Technical Assistance Information Exchange Instrument) nga ekspertë të kësaj fushe të Komisionit Evropian. Nga palët e interesit janë pranuar vërejtje, komente dhe sugjerime. Ato pastaj janë shqyrtuar dhe analizuar një nga një, ku mjaft prej tyre janë pranuar si të drejta e disa të tjera nuk janë pranuar dhe u është dhënë përgjigje e argumentuar. Qëllimi dhe fushëveprimi i Projektligjit ka për qëllim vendosjen e rregullave për sigurimin e afrimit të shërbimit postar dhe shërbimit universal postar, përcaktimin e kushteve për qasje në rrjetin postar, nxitjen e konkurrencës së lirë, përcaktimin e parimeve për tarifën, sigurimin e transparencës së llogarive të afrimit të shërbimit universal postar, përcaktimin e standardeve për shërbimin universal postar dhe vendosja e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me këto standarde. Me këtë projektligj përcaktohen detyrat dhe kompetencat e MZHE-së dhe të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) në fushën e shërbimeve postare, të drejtat dhe detyrimet e afruesve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve postare, si dhe rregullimi i çështjeve të tjera që ndërlidhen me shërbimet postare. Ky Projektligj është në përputhshmëri me dispozitat që kanë të bëjnë me rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm - Direktiva 97/67/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 dhjetor 1997, për rregullat e përbashkëta për zhvillimin e tregut të brendshëm të shërbimit postar të Komunitetit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit, e ndryshuar me Direktivën 2002/39/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 qershor 2002 dhe Direktiva 2008/6/KE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian më 20 shkurt 2008.

Hykmete Bajrami kërkoi sqarim pse nuk është ministri apo ndonjë zëvendësministër nga Ministra e zhvillimit ekonomik, për të e paraqitur parim Projektligjin. Po ashtu, kishte kritika lidhur me gjendjen në Postë, si Ndërmarrjen Publike dhe për raportin vjetor të performancës së Ndërmarrjeve Publike, për vitin 2015-2016?

Nazmi Zenelaj, sekretar i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, tha që në fillim kërkova ndjesë për mos prezencën e ministrit për shkak të angazhimeve, ndërsa, sqaroi se është në

cilësinë shërbyesit civil dhe nuk mund të komentojë më shumë rreth çështjeve të ngritura politike, por vetëm për çështjet që rregullon Projektligji. Ndërkaq, rreth çështjes së Raportit të performancës, tha se për këtë është kompetente të raportojë Njësia për Monitorimin e ndërmarrjeve publike që i raporton ministrit, andaj, rrjedhimisht edhe kjo çështje nuk është në kompetencë të tij.

Kryesuesi i mbledhjes, Dardan Sejdiu, ndërpreu debatin, duke kërkuar që të diskutohet në rend dite për projektligjin, pasi që komisioni në një nga mbledhjet e radhës do të diskutojë për Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike.

Hykmete Bajrami, lidhur me veprimet 5- vjeçare, për shërbimet e rezervuara postare, siç e parasheh projektligji, pyeti se cili do të jetë ndikimi financiar i Postës në këtë rast për afrimin shërbimeve postare?

Agim Kukaj, përfaqësues i ministrisë, tha se projektligji rregullon tregun e shërbimeve postare dhe atyre private, dhe në aspektin shërbimeve universale, është zona e rezervuar për Postën e Kosovës sh. a., si afrues i shërbimit universal postar, me afat 5- vjeçar në përputhje me këtë Ligj. Posta e Kosovës e bënë planin e shërbimit që është për këtë përdhën 5- vjeçare, më qëllim të afarizmit pozitive.

Kryesuesi e vlerësoi pozitivisht periudhën 5- vjeçare për shërbimet postare të rezervuara për ta mbrojtur Postën e Kosovës, ndërsa, lidhur më nenin 21, sa i përket kushteve, pyeti se kush e mbikëqyrë plotësimin e kushteve për afrimin shërbimeve postare?

Agim Kukaj, përfaqësues i ministrisë, tha se është kompetencë e Autoritetit Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - ARKEP.

Pas debatit, komisioni unanimitisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-038 për Shërbimet Postare.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-038 për Shërbimet Postare.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha- Shala, kryetare e komisionit.*

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-037 për Metrologji

Kryesuesi tha se ky projektligj është proceduar nga Qeveria në Kuvend për shqyrtim, ku për ta paraqitur në parim ia dha fjalën zëvendësministrit, z. Faton Thaçi.

Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, tha: Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e projekti legjislativ që në pika të shkurta të paraqesë arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për Metrologji. Arsyja për hartimin e projektligjit për Metrologji është rregullimi i

kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimit sa me të përafërt me Direktivat e Parlamentit Evropian për fushën e metrologjisë, të cilat përcaktojnë kriteret dhe kërkesat relevante teknike për vlerësimin e konformitetit për mjetet matëse të cilat do të jenë të harmonizuara plotësisht me kriteret dhe kërkesat relevante teknike të cilat përdoren në vendet e BE-së. Ligji aktual nr. 03/L-203 për Metrologji ka disa paqartësi dhe mangësi të cilat në detaje janë përshkruar në Koncept- Dokument, ku si rezultat i tyre janë shfaqur pengesa në implementim e tij. Qëllimi kryesor për hartimin e projektligjit për Metrologji është rregullimi i sistemit të njëjësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbrojtjen e konsumatorëve dhe sigurisë së përgjithshme nga rezultatet e pasakta të matjeve. Arsyeshmëria tjetër e hartimit të këtij projektligji është kërkesë decidive, e cila rrjedh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit në tetor të vitit 2015 në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Projektligji për Metrologji është hartuar me mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të BE-së të kësaj fushe, të cilët janë financuar përmes projektit IPA 2012 dhe të cilët kanë dhënë kontributin e tyre, që ky Projektligj të jetë sa më kompakt që është e mundur duke afruar mjaft detaje për të adresuar politikat e shtetit ku involvohen matjet, të hartohet në përputhshmëri me edicionet e fundit të dokumenteve të aplikueshme ndërkombëtare për fushën e metrologjisë (Dokumenti D1-versioni 2012 i Organizatës Botërore për Metrologji Ligjore -OIML-së) dhe po ashtu do të jetë në përputhje me zhvillimin e politikave shtetërore me qëllim që të jenë në gjendje të mbështetin një infrastrukturë efektive të sistemit të metrologjisë në Kosovë.

Hykmete Bajrami pyeti lidhur me mbikëqyrjen e metrologjisë, pasi që Agjencia e Metrologjisë, është themeluar, është thënë së do ta formojnë edhe një departament të inspektoratit në kuadër të metrologjisë, a keni bërë pjesë të mbikëqyrjes së metrologjisë nëse është bërë a është konflikt interesi? Ndërkaq, paralajmëroi se komentet e saj do t'i paraqesë në formë amendamentesh në mes dy leximeve.

Isa Elshani, përfaqësues i ministrisë, tha se i kemi analizuar praktikat evropiane, kemi gjetur së mbikëqyrjen e metrologjisë e bëjnë zyrtarët e metrologjisë, sepse stafi duhet të jetë përgjegjës dhe personel i kësaj fushe.

Pas debatit, komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-037 për Metrologji.*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-037 për Metrologji.*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha -Shala, kryetare e komisionit.*

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit

Kryetarja tha se ky projektligj, po ashtu është proceduar nga Qeveria në Kuvend për shqyrtim, ku për ta paraqitur në parim ia dha fjalën zëvendësministrit, z. Faton Thaçi.

Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, theksoi që në pika të shkurta po e paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit. Arsyet për hartimin e Projektligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit janë rregullimi i kësaj fushe në bazë të kërkesave të tregut dhe harmonizimit sa me të përafërt me Rregulloren 765/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 9 korrik 2008, që ka të bëjë me përcaktimin e kërkuar për akreditim dhe mbikëqyrje të tregut për vendosjen e produkteve në treg dhe Vendimit 768/ 2008/ EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 9 korrik 2008, për një kuadër të përbashkët për marketingun/tregtimin e produkteve. Ligji aktual nr. 04/L-039 ka disa paqartësi dhe mangësi të cilat në detaje janë përshkruar në Koncept Dokument dhe si rezultat i tyre po shfaqen pengesa në implementim. Qëllimi kryesor për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit është krijimi i një baze të përshtatshme legjislative mbi të cilën mund të vlerësohet dhe bëhet i njohur konformiteti dhe kërkesat teknike të produkteve industriale jo ushqimore, duke mundësuar kështu zbatimin më të lehtë dhe respektimin e dispozitave ligjore Kosovës për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit, si dhe përmbushjen e obligimeve të tjera ligjore që do të paraqiten. Arsyeshmëria tjetër e hartimit të këtij Projektligjit për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit është kërkesë decitive e cila rrjedh nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (neni 80, Vlerësimi i Konformitetit) në tetor të vitit 2015 nga Republika e Kosovës dhe Bashkimi Evropian (BE). Projektligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit ndërlidhet me objektivat e Qeverisë respektivisht të MTI-së, siç është Programi për Reforma Ekonomike (PRE) dhe është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë së Kosovës.

Hykmete Bajrami paraqiti vërejtje në projektligj lidhur më nenet në vijim: Neni 5; neni 15, paragrafi 2; neni 17; neni 28, paragrafi 2 dhe paragrafi 4. Ajo theksoi së këto dispozita duhet të qartësohen. Dhe se për gjitha këto paqartësi, në mes të dy leximeve, do t'i paraqesë amendamentet që e rregullojnë më mirë këtë projektligj.

Pas debatit, komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet në parim Projektligji nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;*
- 2. I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.06/L-041 për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit;*
- 3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet deputetja, Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.*

Kryetarja tha pasi që e kemi këtu zëvendësministrin e MTI-së, kërkoj sqarime për letrën e dërguar nga ministri lidhur më Projektligjin për masat mbrojtëse në importe.

Faton Thaçi, zëvendësministër i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, para komisionit lexoi letrën e Ministrit Bajram Hasani, ku ndër të tjera, sqaron se arsyeja pse nuk janë përfshirë në Pako me Projektligjin për masat mbrojtëse në importe, Ligji për Masat antidamping dhe Ligji për Tregti të Brendshme, është për faktin se këto dy projektligje janë në harmoni me legjislacionin e BE-së, dhe nuk i kemi paraparë të përfshihen në agjendë legjislative për këtë vit.

Lidhur më këtë çështje debatuan **deputetët Memli Krasniqi, Bilall Sherfi dhe Hykmete Bajrami.**

Kryetarja propozoi që ky projektligj të përfshihet në rend dite në mbledhjen e radhës dhe komisioni të marrë një qëndrim.

Komisioni u pajtua më propozimin e kryetares.

6. Formimi i grupeve të punës për shqyrtimin e projektligjeve

Kryetarja tha se pasi që i kemi miratuar në parim disa projektligje në mbledhjet e kaluara dhe ato kanë kaluar leximin e parë në Kuvend, propozoi që të formohen grupet e punës për shqyrtimin e tyre:

Komisioni unanimisht vendosi për grupet e punës, si vijon:

1. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-027 për Miniera dhe Minerale dhe Projektligjit nr.06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës, ka këtë përbërje: Sala Berisha Shala, kryesuese, Dardan Sejdiu, Mimosa Kusari – Lila, Bilall Sherifi dhe Duda Balje anëtarë.
2. Grupi punues për shqyrtimin e Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, ka këtë përbërje: Dardan Sejdiu kryesues, Mimoza Kusari – Lila dhe Gani Dreshaj, anëtarë.

7. Të ndryshme

a) Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për energjinë elektrike

Kryetarja kërkoi nga kryesuesi i grupit të raportojë lidhur më procesin e mbikëqyrjes së këtij Ligji.

Dardan Sejdiu tha se kemi pritur një analizë model nga INDEP, dhe se shpejti grupi do të fillojë punën.

Komisioni kërkoi nga grupi i punës që të intensifikojë punën e mbikëqyrjes së Ligjit.

b) Vizita në agjencitë e pavarura që i raportojnë komisionit

Kryetarja tha se në plan të punës kemi për të vizituar AKP- në dhe AKK- në.

Memli Krasniqi propozoi të vizitohet Autoriteti i Aviacionit Civil – AAC, për ta shikuar gjendjen në këtë sektor.

Komisioni vendosi që të vizitohet AAC-ën, më 27.2.2018, pas mbledhjes.

c) Përgatitja e rendit të ditës për mbledhjen e radhës

Kryetarja njoftoj së, komisioni tani më ka përfunduar të gjitha çështjet që ka në shqyrtim, dhe ka mbetur vetëm Raporti i Përformancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016.

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të shqyrtohet Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2015 dhe 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA